

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **207-24-12176-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Punë ndërtimore për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore] për ndërtimin dhe rindërtimin e stadiumeve në Ferizaj, në Pejë, në Prizren dhe në Vushtrri, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	ERK CONSTRUCTION INC Dega në Kosovë
NUI	812194661
Adresa	Rr. Besnik Osmani, Ndertesa EB Invest, Lokali nr.2
Vendi	Ferizaj
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	38346500053
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Shabi Rexhallari
Adresa elektronike	info.ks@erkconstruction.ca
Data e parashtrimit të ankesës	30.06.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Ferizaj, në përputhje me Kategorinë III plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA

Njoftimi për Kontratë: 18.11.2024

Data e hapjes së ofertave: 08.01.2025

Njoftimi mbi vendimin dt.09.06.2025

Kërkesë për rishqyrtim: 16.06.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 20.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraparak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 65 i LPP-së
Neni 68 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 11 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 65 i LPP-së

Neni 68 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për Kontratë është publikuar me dt.18.11.2024, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 08.01.2025.

Ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në katër Lote, ndërsa ne si grup i operatorëve ekonomik kemi ofertuar vetëm **në Lot 1 dhe jemi të renditur oferta e dytë me çmim më të lirë. Më i lirë se sa oferta jonë është vetëm OE i rekomanduar për kontratë.**

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.09.06.2025, ku për **Lot 1** është rekomanduar për kontratë OE **BM Group SH.P.K**, kurse ne jemi eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Para se ta shtjellojmë paqëndrueshmërinë e arsyes së eliminimit të cekur në letrën standarde për tenderues të eliminuar e cila na është dërguar neve, po e pasqyrojmë aspektin procedural se si ka rrjedh deri te publikimi i njoftimit mbi vendimin B58.

Me dt.10.04.2025 AK-së ka kërkuar nga të gjithë OE të zgjasin vlefshmërinë dhe sigurimin e ofertës, kurse ne e kemi vazhduar vlefshmërinë e këtyre dy dokumenteve me dt.11.04.2025.

Skadimi i vlefshmërisë së ofertave ka ardh për shkak të neglizhencës dhe zvarritjes së procedurës së vlerësimit të ofertave, pasi që ky proces është stërzgatur mjaft shumë duke u tejkaluar të gjitha afatet ligjore. Hapja e ofertave është bërë me dt.08.01.2025, ndërsa publikimi i formularit B58 është bërë me dt.09.06.2025.

Neni 40 i RRPP Nr.001/2022 e përcakton qartë afatin për vlerësim të tenderëve, si më poshtë:

*“40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se **30 ditë nga hapja e ofertave**. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë **prej 20 ditësh**. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve”.*

Me dt.25.04.2025 autoriteti kontraktues ka kërkuar nga ne plotësim të dokumentacionit si më poshtë, citojmë:

Pra nga ne fillimisht na janë kërkuar sqarime për faturat me transaksione vetëm për referencat në sektorin privat dhe raportet e auditimit për vitet 2021,2022,2023, të cilat i kemi bashkëngjitur me sqarime shtesë. Me sqarime kemi bashkëngjitur transaksionet për tri kontratat e realizuara nga ERK.

Më pastaj për herë të dytë me dt.15.05.2025 na janë kërkuar sqarime për të ofruar transaksionet ose dëshmitë tjera për referencat e sektorit privat konkretisht për kontratat e Operatorit Ekonomik **Pepa Group SH.P.K.**

Në lidhje me këto kontrata, ne kemi sqaruar në detaje edhe kemi bashkëngjitur dëshmitë përkatëse që dëshmojnë se punët janë kryer të gjitha dhe me seriozitet.

Pas procedurës së sqarimeve, **me dt.09.06.2025** publikohet njoftimi mbi vendimin e AK-

së dhe rekomandohet për kontratë OE **“BM Group SHPK”** me çmim më të lirë se sa oferta e grupit tonë, prandaj për neve është shumë i habitshëm ky veprim i AK-së. Habia jonë ndërlidhet me pyetjen se përse na janë kërkuar neve sqarime kur kemi çmim më të lartë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë dhe nëse do të ishte oferta e tij e përgjegjshme. Sqarimet nga ne do të kishin kuptim vetëm nëse ofertat më të lira se ne janë

të papërgjegjshme, e që ne dyshojmë dhe mendojmë se oferta e OE BM Group është e papërgjegjshme, mirëpo që AK-së nuk e ka cilësuar në këtë mënyrë. Pra ne konsiderojmë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshëm dhe për këtë arsye na janë kërkuar neve sqarime, mirëpo që në momentin e fundit vlerësimi është bërë jo profesionalisht dhe është rekomanduar për kontratë ky OE kurse ne jemi eliminuar.

Sidoqoftë tani po e shtjellojmë dhe e faktojmë se arsyeja e eliminimit tonë është pa qëndrueshme dhe kundërligjore.

Sa i përket arsyes së eliminimit ku është cekur se ne nuk kemi arritur të përmbushim vlerën e kërkuar në dosje të tenderit për kontrata të natyrës së ngjashme nga vlera e kërkuar prej 19,0000.000.00€ dhe se ne kemi arrit të dëshmojmë vetëm vlerën 17,704,676.00 €, fillimisht sqarojmë se ky pretendim i AK-së është i përgjithësuar pasi që nuk është cekur se cilat kontrata nuk janë marr parasysh kështu që ky pretendim rezulton të jetë i pa argumentuar totalisht dhe tendencioz.

Për kontratat e OE Pepa Group të realizuara me kompani private të cilat janë renditur më poshtë ne kemi dhënë sqarime shtesë me dt.19.05.2025, ku i kemi bashkëngjitur dëshmitë si më poshtë:

1. Transaksionet PEPA GROUP – DEAD SHPK, PEPA GROUP – PEPA GROUP
2. Kontrata PEPA GROUP – REAL FOOD, e noterizume me kompenzime
3. Kontrata PEPA GROUP – BENI-S 2015 SHPK e noterizume me kompenzime,
4. Transaksionet PEPA GROUP – CAPITAL RESCOURES

Sa i përket kontratave të lartcekura, sqarojmë se për kontratën PEPA GROUP – CAPITAL RESCOURES i kemi bashkëngjitur edhe transaksionet dhe të gjitha dëshmitë e tjera, duke përfshi formularin e vlerësimit.

Sa i përket tri kontratave të tjera të realizuara nga Pepa Group SHPK sqarojmë se janë realizuar këto kontrata dhe sqarimet janë si më poshtë.

1. **Pepa Group Shpk e lidhur me Beni S-2015 shpk, vlera 3267052.58.** Ne edhe me sqarimet shtesë i kemi sqaruar këto kontrata, por edhe njëherë po e

elaborojmë. Sipas renditjes ne listë-tabelen **NR.3** (Godine banimi dhe shërbimi,3,4,6 dhe 8 kate dhe 2 kate nën tokë, këtë projekt kompania PEPA GROUP ka kryer punë ndërtimore dhe furnizimit me te gjitha materialet dhe si kompenzim - klering.

Si argument sqarues shitesë është bashkangjitur kontrata e “noterizuar” me Nr.7217 e dates 16/09/2019 ne mes te Shoqerisë ‘BENI S-2015 shpk” -kontraktori dhe PEPA GROUP” shpk -nëkontraktori-me titull l”KONTRATE - NENKONTRAKTORE ME SHKEMBIM”

Kemi nënvizuar në veçanti Nenin 1 të kësaj kontrate, pikat 1.1 dhe pikat 1.2 ku kompania PEPA GROUP shpk ka marr ne kompensime 100% me m² ndërtimi nga investitori ne kundërvlere prej 3,267,052.58 euro, ne metra katrorë ndërtimi 2450m² (shikoni neni 1 paragrafi 1.2 kesaj kontrate), çmimi i kontraktuar ne kundërvlerë mesatare ka qenë rreth 1350 euro/m². Pra Pepa Group në këtë kontratë ka qenë nëkontraktor por për punën që e ka bërë nuk është paguar por ka marr 2,450 m² ndërtim.

Kontrata Pepa Group Shpk e lidhur me Daed Shpk vlere 886859.75.Në lidhje me referencën e lëshuar nga Daed, sqarojmë se kemi bashkangjitur kontratën e cila është e noterizuar tek Rezarta B. Koçi, e ku në këtë kontratë janë përcaktuar dhe specifikuar detajet e kompensimit, prandaj vlere e kësaj kontrate duhet të merret parasysh. Gjithashtu janë bashkangjitur edhe faturat me noter dhe leja e ndërtimit.

Kontrata e noterizuar” me Nr.566 e datës 25.01.2021 ne mesë shoqerisë “DAED shpk” ne cilësinë e sipermarrës/kontrator dhe ne, në cilësinë e sipërmarrësit “PEPA GROUP shpk” për kompensime -klering ne ndërtimin e objektit, ku kosto e ndërtimit është 450 euro/m² ndërtim dhe si kompenizim -klering ka realizuar ne kundërvlerë 845m² me çmim rreth 1,300 euro ose shumë totale prej 886,859.75 euro, poashtu për këtë kemi dërguar edhe informata tjera shitesë te pranimi teknik si dhe faturat e dërguara ne kundërvlerë për punën e kryer PEPA GROUP – DEAD shpk.

2. **Kontrata Pepa Group Shpk 3921776.29, vetë investitor dhe vetë ndërtues,** vlere 3921776.29. Kontrata Godinë banimi dhe shërbime 2,3,5,7,8,9,10 dhe 11 kate dhe 2 kate nëntoksore Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë, ndërtimi dhe furnizimi me te gjitha materialet nga Pepa Group.

Si argument shitesë e kemi dërguar lejen ndërtimore për projektin i cili është ndërtuar I teri -investitor dhe ka qene pronësi 100% nga vet PEPA GROUP shpk, si dhe e kemi bashkangjitur pranimin teknik – AKT KOLAUDIMI te këtij projekti te dates: 30.07.2024 dhe sipas këtij akti kolaudimi te pikës 7 shuma është prej

495,329,584.41 lekë pa tvsh ose ne kundër vlerë prej 4,953,295 euro pa tvsh..

Pra ky projekt është ndërtuar nga vetë Pepa Group SHPK dhe është shitur nga vet kompania PEPA GROUP dhe transaksionet dhe pagesat janë pjese e përgjithshme ne xhiron-qarkullim te vete PEPA GROUP ku ne kemi dorëzuar tek AK-së raportet e qarkullimeve bankare si tersi për këtë projekt dhe te gjitha projektet tjera.

Veprimet e autoritetit kontraktues gjatë vlerësimit të këtyre kontratave që janë realizuar me kompani private dhe me kompensime po rezulton të janë kundërthënëse, pasi që i njëjti institucion këto kontrata të Pepa Group i ka pranuar të vlefshme për nga përmbajtja por nuk i kishte pranuar vetëm për **shkak të datave të pranimeve teknike** përkatësisht të kolaudimeve në një tender tjetër. Rasti për të cilin po e përmendim është tenderi me titull **“Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit ne Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA” me nr prok: 207-24-8996-5-1-1**, ku ofertues ka qenë Grupi i Pepa Group &Conex L.L.C & Agri Construction sh.p.k, ndërsa ky grup ishte eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Kontratat që tani neve nuk na janë marr për bazë, në projektin e lartcekur nga institucioni i njëjtë iu është kontestuar **vetëm data e realizimit**, pra kontratat e njëjta por veprime të ndryshme të të njëjtit autoritet kontraktues. Ne kemi analizuar edhe ankesën e grupit të OE ankues (Conex L.L.C&Agri Construction SHPK) në atë tender, e ku ndër të tjera e kishte cekur në ankesë si në vijim:

Të gjitha këto dëshmi gjenden në web faqe të OSHP-së, siç janë ankesa, ekspertiza dhe vendimi i OSHP-së, pra janë dokumente publike.

Duke pasur parasysh veprimet e AK-së vërehet përdorim i standardeve jo të njëjta në aktivitet të ndryshme dhe për kontrata të njëjta, prandaj në këtë tender ne jemi të diskriminuar nga veprimet e AK-së. Dhe këto veprime përbëjnë shkelje të dispozitave të

nenit 7 të LPP-së.

- Kur analizohet lista e kontratave të OE Pepa Group Shpk vërehet se vlera totale e kontratave është 13,795,901.92 €.
- Gjatë një analize që ne e kemi bërë pas pranimi të letrës standarde për tenderues të eliminuar kemi ardh në përfundim se edhe kontrata me titull **“Hartimi I projektit dhe zbatimi I punimeve për ndërtimin e godines 12 (Seksioni A) në zonën Zhvillimore " 5 Maji" me Bashkinë Tiranë me vlerë prej 3,654, 299.32 €**, nuk është pranuar.

Në lidhje me këtë kontratë e kemi vërejt se ne gabimisht nuk kemi bashkëngjitur referencën përkatësisht pranimin teknik, mirëpo edhe AK-së ka përdor standard të dyfishtë me rastin e kërkesës për sqarime shtesë, sepse nuk ka kërkuar që të ofrojmë referencën apo procesverbalin e pranimi teknik, pasi që kjo kontratë figuron tek lista e kontratave. Pra autoriteti kontraktues nuk kërkon sqarime shtesë për kontratën e cila ka qenë e lidhur me institucion publik siç është **Bashkia Tiranë** por kërkon sqarime vetëm për referencat me kompani private.

Në këto rast duhet të kërkohe sqarime, pasi që edhe neni 10 i UDHËZUESIT Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, e lejon dhe përcakton një mundësi të tillë.

Sa për dijeninë tuaj ne po ua bashkëngjisim formularin e vlerësimit dhe kolaudimit të kësaj kontrate e ku shkruan data e përfundimit të kontratës 16.04.2024, kurse data e kolaudimit 20.06.2024, e që me këtë dokument dëshmohe se kjo kontratë ka qenë e përfunduar dhe kjo dëshmohe në mënyrë objektive sipas nenit 72.3 të LPP-së.

Kur kem parasysh vlerën të cilën e ka llogaritur AK-së prej **17,704,676.00 €**, kinse ne kemi arrit të dëshmojmë për kontrata të ngjashme dhe kur ja shtojmë vetëm vlerën e kësaj kontrate prej **3,654, 299.32 €** atëherë rezulton se ne kemi kontrata të ngjashme në vlerë prej 21,358,975.30 €, vetëm edhe me këtë kontratë.

Me sqarime shtesë i kemi bashkangjit edhe transaksionet jo vetëm për këtë kontratë por edhe për dy kontratat tjera të titulluara si më poshtë:

- **CONTRACT 22346-DEMOLITION OF EXISTING BRIDGE STRUCTURE, CONSTRUCTION OF PRECAST PRESTRESSED CONCRETE GIRDER BRIDGE AND OTHER WORK**, me vlerë prej 1,834,066.1€, ku autoritet kontraktues është ALBERTA TRANSPORTATION AND ECONOMIC CORRIDORS
- **WEST CALGARY RING ROAD HIGHWAY 8 TO OLD BANFF COACH ROAD SEGMENT** me vlerë prej 2, 195,809.08 €, ku autoritet kontraktues është CALGARY SAFELINK PARTNERS

Në aspektin procedural, autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së por e ka shfrytëzuar këtë dispozitë parciaisht ashtu siç i ka konvenuara asaj, e siç po kuptohet vetëm për të na diskriminuar dhe dëmtuar grupin tonë ofertues dhe ky fakt kuptohet shumë lehtë kur kem parsh se AK-së na ka kërkuar sqarime për kontratat e lidhura me kompani private, **ndërsa nuk ka kërkuar sqarime për kontratat që janë përfunduar me institucione publike** por që nuk janë bashkëngjit referencat edhe pse këto kontrata kanë qenë e cekur në listë të kontratave.

Duke pasur parasysh sqarimet e lartcekura kuptohet qartë se grupi jonë ofertues është i përgjegjshëm dhe tenderi i dorëzuar nga ne është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duhet të konsiderohet i përgjegjshëm ashtu siç parashihet edhe në nenin me nenin 59.4 të LPP-së.

- **Sqarim për mos lejimin e qasjes në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë.**

Ne me dt.10.06.2025 përmes platformës elektronike kemi kërkuar qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë dhe të ofertuesve tjerë, kurse me dt.11.06.2025 na është lejuar qasja në dokumente mirëpo kjo qasje **ka qenë shumë e kufizuar**, ku autoriteti kontraktues na ka thënë se OE BM Group ka deklaruar sekret afarist dokumentet e tij, ndërsa me qasje na janë dhënë vetëm dokumentet si më poshtë:

Në procesverbal të qasjes në dokumentacion është shënuar se AK-së mund ti klasifikojë informatat e tjera sekret afarist vetëm nëse këto informata i përmbushin tri kriteret e nënparagrafit 3.1 të nenit 11 të LPP-së përkitazi me nenin 68 dhe 69 të LPP-së.

Sa për dijeninë tuaj, ne nuk kemi pa asnjë deklaratë apo arsyetim me shkrim nga OE i rekomanduar për kontratë me të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike dhe se bindshëm demonstroi sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Përderisa nuk janë dhënë këto arsyetime nuk duhet të pranohet blanko kërkesa për sekret afarist sepse është e kundërligjshme. Nga këto dëshmi vërtetohet saktë se është favorizuar OE i rekomanduar duke iu aprovuar kërkesa për sekret afarist pa i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuar në dispozitat e LPP-së

Autoriteti kontraktues në momentin që nuk na ka lejuar qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk ka respektuar nenin 10 dhe 11 të LPP-së, e po ashtu edhe LIGJIN NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE.

Me këto veprime të autoritetit kontraktues nuk është respektuar edhe neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që qasja në dokumente publike është e garantuar me kushtetutë.

☞ **OE “BM Group Shpk” i rekomanduar për kontratë për Lot 1 ka kërkuar që**

dokumentet e tij të jenë sekret afarist, mirëpo ne konsiderojmë se ky OE është i papërgjegjshëm duke i ditur dokumentet e tij nga tenderët e kaluar, prandaj mbi këtë bazë edhe do të ngritim pretendimet tona ankimore në raport me këtë kompani.

Fillimisht sqarojmë se ky OE vërtetimin e ATK-së e ka me borxhe, kurse dyshojmë që marrëveshjen për borxhe e ka të nënshkruar pas njoftimit për kontratë dhe me këtë fakt ky OE duhet të shpallet ofertues i papërgjegjshëm.

Kjo kërkesë është përcaktuar tek neni **6.4 i FDT-së**, ku është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa numër 2 Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit -vetëm për fituesin.

Dëshmitë për kërkesën nr.2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin.

Me dt.16.06.2025 me email autoriteti kontraktues na ka dërguar marrëveshjen për borxh që e ka pasur OE i rekomanduar për kontratë por kjo marrëveshje e ka **dt.06.06.2024** dhe aty shihet se kësti i fundit i marrëveshjes për pagesë të borxhit është **dt.08.04.2025**.

Vërtetimi i ri i ATK-së është nxjerr me **dt.05.06.2025** ku shkruan se është në marrëveshje për shlyerjen e borxheve. Nga ky fakt kuptohet se ky OE ose **nuk i është përmbajtur marrëveshjes** për shlyerje të borxheve dhe ka bërë një marrëveshje të re **ose pas përfundimit të pagesës së borxheve kanë lind borxhe të reja** dhe që ka mundur të bëhet marrëveshje e re për borxhe. Mbi këtë bazë dhe në secilin variant çdo marrëveshje e re është e bërë pas datës së njoftimit për kontratë dhe ky OE është i papërgjegjshëm.

Këtë e përcakton qartë pyetja nr.6 tek pyetjet e shpeshta në KRPP. Ju lutem analizoni interpretimin e KRPP. Veprimi i AK-së bie në kundërshtim edhe me nenin 65 të LPP-së.

Dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë **nuk ka mjete në llogari në vlerën e**

kërkuar, e po ashtu vërtetimin nga Banka nuk e ka për qasje në kredi të pakushtëzuar ashtu siç është kërkuar. Mbi këtë bazë, madje kemi kërkuar nga AK-së që të verifikojë këto dokumente në harmoni me nenin 52.7 të LPP-së pasi që ka mundësi këto dokumente janë edhe të falsifikuara. Po ashtu kërkojmë edhe nga OSHP-ja që brenda kompetencave të bëjë një verifikim të këtyre dokumenteve.

Zakonisht ky OE e merr një vërtetim nga Banka e ku shënohet se do ti lëshohet kredi në vlerën e kërkuar **nëse e fiton** tenderin dhe **nëse i plotëson** kushtet e përcaktuar nga banka. Nëse e ka vërtetimin në këtë mënyrë (ne dyshojmë se e ka kështu) dhe me tekst përafërsisht të njëjtë atëherë kjo nuk është qasje e pakushtëzuar në kredi por është qasje e

kushtëzuar.

Gjithashtu dyshojmë se ky OE nuk ka ofruar dëshmi për qarkullim në vlerën e kërkuar, dhe nuk ka ofruar raportet e auditimit dhe të menaxhimit sipas kërkesës së lartcekur. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues që të analizojë dokumentet në detaje dhe të verifikohet se a e plotëson këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë.

Dyshojmë se ky OE nuk ka ofruar referenca apo procesverbale teknike të punëve të

natyrës së kërkuar në vlerën e kërkuar dhe këtë dyshim e mbështesim nga përvoja e kaluar nëpër tenderime të ndryshme ku ky OE ka qenë ofertues dhe kur nuk ka përcaktuar sekret afarist dokumentet e tij.

Dyshojmë se disa kontrata i ka të papërfunduara, e disa kontrata i ka vetëm me furnizime, instalime elektrike etj. Disa kontrata i ka me kompani private e për të cilat nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj duhet të eliminohet kjo kompani nga konkurrenca. Edhe për dëshmitë e ofruara në lidhje me kontratat dhe referencat kërkojmë nga eksperti shqyrtues ti analizojë në detaje secilën kontratë dhe dëshmi dhe të jep mendim profesional në lidhje me dëshmitë e ofruara.

Vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.20.06.2025.

Edhe nga kjo përgjigje kuptohet qartë që mungojnë kundër argumentet e autoritetit kontraktues në raport me dëshmitë e ofruara nga ne dhe mungon arsyeshmëria konkrete për eliminim por përsëri sikurse në arsyen e eliminimit vetëm në mënyrë të përgjithësuar dhe sipërfaqësisht ceket se ne nuk e kemi plotësuar kërkesën në lidhje me vlerën e kontratave dhe referencave.

Autoriteti kontraktues me rastin e shqyrtimeve të pretendimeve ankimore ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së paragrafi 9 sepse nuk ka arsyetuar vendimin për refuzim, ndërsa në këtë dispozitë ceket shumë qartë:

Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të

pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

Pretendimi ynë ka qenë se arsyetja e eliminimit ka qenë e përgjithësuar dhe nuk e kemi ditur se cilat kontrata nuk janë marr parasysh por autoriteti kontraktues ka vazhduar me shkelje ligjore ku përsëri në mënyrë jo profesionale dhe në mënyrë diskriminuese nuk jep arsye konkrete në lidhje me eliminimin tonë dhe në lidhje me pretendimet ankimore. Ky veprim i AK-së paraqet arbitrarizëm të plotë.

Ne e tejkalojmë vlerën e kontratave të kërkuara në dosje të tenderit dhe kjo dëshmohet shumë qartë kur analizohen dokumentet e ofruara nga ne.

Nga tentimi për të arsyetuar veprimin e tyre në raport me OE e rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues shpërfaq hapur tendencën favorizuese e po ashtu nuk mund ta kundër argumenton fare përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

Fillimisht sqarojmë se neni 65 paragrafi 4.8 përcakton që fare nuk duhet të ketë borxhe OE për të qenë i përshtatshëm e që në këtë rast nuk është plotësuar kjo kërkesë sepse OE i rekomanduar për kontratë ka borxhe. Pavarësisht këtij fakti autoriteti kontraktues nuk arrin të argumentojë se OE i rekomanduar për kontratë është i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së, sepse i referohet vetëm marrëveshjes së **dt.06.06.2024 për shlyrjen e borxheve**. Nëse do ti përmbahej marrëveshjes në fjalë atëherë ky OE do ta kishte vërtetimin e ATK-së pa borxhe.

Tendenca e fshehjes së të vërtetës dhe mbulimit të mangësive të OE të rekomanduar për kontratë vërehet shumë qartë në këtë përgjigje, ku autoriteti kontraktues nuk përgjigjet fare dhe nuk jep arsyetim përse vërtetimi i ATK-së i **dt.05.06.2025** figuron me borxhe dhe nuk merret fare **me marrëveshjen e re për shlyerje të borxheve**. Përkundrazi në mënyrë implicite autoriteti kontraktues e pranon se marrëveshja për shlyerje të borxheve është pas datës së njoftimit për kontratë kur në vend se të përgjigjet për vërtetimin e ri të ATK-së, i referohet një ekspertize të kaluar të ekspertit të OSHP-së Nr.2025/0214.

Sa për sqarim, në ekspertizën të cilës i referohet AK-së nuk ka qenë diskutabile vërtetimi i ATK-së i **dt.05.06.2025** por ka qenë vërtetimi i dt.06.06.2024, prandaj arsyetimi i AK-së është tentim i qartë për të na vënë në lajthitje neve dhe më pastaj OSHP. Pra tani kemi të bëjmë me një vërtetim tjetër me borxhe i cili vërtetim duhet të studiohet dhe të analizohet

në detaje konkretisht duhet të vërtetohet se kur është nënshkruar marrëveshja për shlyerjen e borxheve, pasi që me këtë vërtetim është shpallur fitues OE i rekomanduar për kontratë.

Po të ishte vërtetimi i ATK-së i dt.05.06.2025 në rregull atëherë do të prezantohej marrëveshja për shlyerjen e borxheve, ndërsa po të ishte marrëveshja konform legjislacionit në fuqi atëherë edhe ne nuk do ta kishim shtruar këtë pretendim.

Nuk mund pretendohet se një OE është i përgjegjshëm nëse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa sa i përket kërkesave të pranueshmërisë secili OE duhet të paraqes dëshmi se është i pranueshëm sipas nenit 65 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues dhe me këtë përgjigje ka vazhduar tendencën për të arsyetuar me çdo kusht rekomandimin për kontratë të OE BM Group SHPK. AK-së kur i konvenon vendimi dhe ekspertiza e OSHP-së nr.214/2025 e përdor atë, ndërsa kur nuk i konvenon e që ne i jemi referuar nuk e merr parasysh këtë ekspertizë dhe vendim.

Nuk është argumentim referimi në ekspertizën dhe vendimin e OSHP-së por argumentim do të ishte nëse i bashkëngjitet Vendimit për refuzim dokumenti nga Banka, prandaj për derisa nuk është dëshmuar në këtë mënyrë përsëri konsiderojmë se nuk është plotësuar kjo kërkesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë. Mbi këtë bazë kërkojmë nga eksperti dhe OSHP-ja që të analizohet në detaje ky dokument se a është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Për OE e rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues përsëri mbështetet në ekspertizën dhe vendimin e OSHP-së nr.214/2025, e po ashtu shihet që ka marr parasysh edhe fotografi gjatë realizimit të punimeve, ndërsa për neve ka përdor standard tjetër të vlerësimit prandaj edhe me këtë përgjigje nuk është argumentuar se OE rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën në lidhje me kontrata dhe referenca në vlerën e kërkuar. Kështu që kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të analizojë në detaje ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe të konstatojë saktë se a e plotëson këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë.

Krejt në fund, ne konsiderojmë se po të ishin plotësuar të gjitha kërkesat nga ana e OE të rekomanduar për kontratë atëherë nuk do të kishte asnjë arsye për hezitim të

publikimit të dokumenteve të këtij operatori ekonomik.

Ne konsiderojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së sepse ne jemi eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, i përcaktuar në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitat e nenit 7 të LPP-së sepse neve na ka diskriminuar gjatë vlerësimit të ofertave, kurse ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe ky fakt është dëshmuar tashmë edhe nga përgjigjet e AK-së në vendimin për refuzim ku në asnjë mënyrë nuk ka arrit që të argumentojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Nga veprimet e autoritetit kontraktues konsiderojmë se grupin tonë ofertues, janë munduar me çdo kusht që të na eliminojnë nga konkurrenca duke kërkuar madje dy herë sqarime shtesë e po ashtu këto sqarime shtesë janë kërkuar jo në harmoni me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së për secilin dokument apo kërkesë. Po ashtu është anashkaluar edhe neni 10 i UOPP Nr. 001/2023, pasi që nuk kanë kërkuar sqarime për kontrata që kanë qenë në listë e që nuk ka qenë të bashkangjitur referenca edhe pse kontrata ka qenë e nënshkruar dhe realizuar me Bashkinë e Tiranës, pra me institucion publik.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të nxjerr:

VENDIM

- I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE “Erk Construction INC Dega në Kosovë & Dea Group SHPK & Sky Group SHPK & Pepa Group**

për Lot 1. Stadiumi në Ferizaj,

- II. ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë rreth 6,000.00 euro, ndërsa dëmet e vërteta nëse nuk nënshkruajmë kontratë do të llogariten më vonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*